



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis dhe Lejeve

Adresa: “ Rruga e Durrësit ”, Nr.27, Tiranë, Tel: 270630, Fax: 270627; www.moe.gov.al

Nr. 287 Prot.

Tiranë, më 21. 05. 2007

UDHËZIM

Nr. 2, datë 21. 05. 2007

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË VEPRIMTARIVE ME NDIKIM NE MJEDIS ,
MËNYRËN E APLIKIMIT DHE RREGULLAT E PROÇEDURAT E
DHËNIES SË AUTORIZIMIT DHE
PËLQIMIT MJEDISOR NGA AGJENCITË
RAJONALE TË MJEDISIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2 të nenit 45, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002, “ Për mbrojtjen e mjedisit ”,

U D H Ë Z O J:

I. Lista e Veprimtarive me ndikim në mjedis që miratohen nga Agjencitë Rajonale të Mjedisit.

1. Veprimtaritë me karakter vendor që ndikojnë në mjedis, të listuara në anekset I dhe II të këtij udhëzimi, miratohen nga Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore.
2. Veprimtaritë e listuara ne Aneksin 1, miratohen me autorizim mjedisor, ndersa veprimtaritë e listuara ne Aneksin 2 te ketij udhezimi, miratohen me pelqim mjedisor.
3. Ne autorizimin dhe ne pelqimin mjedisor, percaktohen kushtet e kerkesat ne baze te te cilave duhet te zhvillohet veprimtaria, me qellim qe te shmangen apo te zbuten ndikimet e saj negative ne shendet dhe ne mjedis.
4. Autorizimi dhe pelqimi mjedisor jane te njevlefshem me lejen mjedisore qe leshon Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujërave (MMPAU).
5. Veprimtaritë qe pajisen me autorizim apo me pelqim mjedisor, respektojne kerkesat e legjislacionit mjedisor dhe te autorizimit e te pelqimit, njesoj si ato qe jane pajisur me leje mjedisore.

6. Veprimtarite qe miratohen me autorizim apo me pelqim mjedisor, i nenshtrohen kontrolleve te Inspektoratit te Mjedisit dhe ndeshkohen prej tij, njesoj si veprimtarite e pajisura me Leje Mjedisore nga MMPAU.

II. Përgatitja e dosjes për autorizim ose për Pëlqim Mjedisor.

1. Për t'u pajisur me **Autorizim Mjedisor**, subjekti pergatit dhe dorezon ne ARM-ne e qarkut ku do te ushtroje veprimtarine, kerkesen me dokumenta ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 249, date 24.04.2003, " Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te elementeve te lejes mjedisore " dhe konkretisht:
 - a) **Kërkesën** drejtuar ARM-se, sipas formatit te percaktuar ne aneksin 3 te ketij udhezimi.
 - b) **Fotokopje të noteruar të vendimit të gjykatës** qe e ka regjistruar subjektin si person fizik ose juridik.
 - c) **Dokumentat teknike** qe pershkruajne veprimtarine qe do te ushtrohet dhe vendin ku do te instalohet (Projekti, skica, planimetri, foto, etj.) te pergatitura nga eksperte te licensuar e fushes.
 - d) **Raportin** e përmbledhur te vleresimit te ndikimit ne mjedis te veprimtarise te hartuar nga eksperte te certifikuar. Raporti hartohet sipas **aneksit 6, bashkelidhur ketij udhezimi.**
 - e) **Dokumenta** qe deshmojne se subjekti ka diskutuar me palet e identifikuara, komunitetin e OJF-te lokale dhe se keta te fundit, jane shprehur per zhvillimin e veprimtarise.
 - f) **Faturën** e pagesës se tarifes se sherbimit.
2. Per t'u pajisur me **Pëlqim Mjedisor**, subjekti pergatit dhe dorezon ne ARM-ne e qarkut ku do te ushtroje veprimtarine:
 - a) **Kërkesën** drejtuar ARM-se per t'u pajisur me pelqim mjedisor.
 - b) **Dokumentat teknike** qe pershkruajne veprimtarine qe do te ushtrohet dhe vendin ku do te instalohet (Projekti, plan vendosja etj.).
 - c) **Një raport të shkurtër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis** te veprimtarise, ne te cilen identifikohen ndikimet kryesore dhe masat e propozuara per minimizimin dhe eliminimin e tyre.
 - d) **Faturën** e pageses se tarifes se sherbimit.

III. Shqyrtimi i dosjes nga ARM

1. Për te administruar procesin e pajisjes me autorizim apo me pelqim mjedisor, ARM-ja hap regjister protokollit te veçante. Regjistrat e protokollit te ARM-se, formatohen dhe shperndahen nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve.
2. Dosja e pergatitur nga subjekti, regjistrohet ne protokollin e ARM-se ne momentin e marrjes ne dorezim nga ARM-ja dhe subjektit i jepet numri dhe data e regjistrimit te dosjes.
3. Pranimi i dosjes, behet pasi eshte verifikuar se ne te jane te gjitha dokumentat qe kerkohen. Kur konstatohen mungesa, subjektit i kerkohen plotesimet dhe dosja futet ne procedure pasi te jene sjelle dokumentat qe mungojne.

4. Nese ne dosje nuk eshte i plote dokumentacioni qe verteton keshillimin me palet e interesuara, pergjegjesi i ARM- se, ne **perputhje me natyren dhe llojin e veprimtarise keshillohet** me organet e qeverisjes vendore, te sherbimit pyjor, te shendetesise, te turizmit, etj, si dhe me perfaqesues te publikut te zones dhe i fton ata ne debat.
5. Kur dosja eshte e plote, brenda **10 diteve** nga regjistrimi i saj, organizohet kqyrja e vendit ku do te zhvillohet veprimtaria dhe hartohet proces-verbali i kqyrjes qe futet ne dosje.
6. Projekti dhe raporti i vleresimit të ndikimit në mjedis i nështrohen debatit publik . Debatit organizohet nga organi i qeverisjes vendore brenda **10 diteve** nga marrja e njoftimit nga ARM-ja. **Pergjegjesi** ARM-se parashtron shkurtimisht kerkesen e subjektit dhe fton te pranishmit te japin mendimet e tyre. Specialistet e çertifikuar qe kane hartuar raportin e VNM-se, japin sqarime rreth çeshtjeve qe dalin gjate debatit. Shqetesimet e banoreve te zones pasqyrohen me proces-verbal.
7. Brenda 2 diteve nga zhvillimi i debatit, ARM-ja i kerkon subjektit te sqaroje dhe te plotesoje me shkrim:
 - a) masat per permiresime **ne** teknologji, ne kapacitete, ne vendin e instalimit te veprimtarise, etj,
 - b) plotesime lidhur me masat shtese per te zvogeluar ndikimet ne mjedis,
 - c) adresimin e shqetesimeve te banoreve te zones dhe ato te organeve shteterore te pranishme.
8. Proçedura e shqyrtimit te kerkeses pezullohet ne se propozuesi nuk dorezon dokumentacionin e plotesuar sipas pikes 7. Koha per plotesime nuk llogaritet ne afatet e shqyrtimit.

IV. Miratimi i autorizimit dhe pëlqimit mjedisor.

1. Pas plotesimit te kerkesave te kreut II dhe III, dosjet paraqiten ne mbledhjen e radhes se ARM-se, per t'u pajisur me autorizim apo me pelqim mjedisor. Mbledhjet organizohen javen e pare dhe te katert te çdo muaji dhe ne te shqyrtohen dosjet sipas numrit te protokollit qe kane.
2. Ne mbledhje marrin pjese te gjithë **inspektoret e mjedisit** (te ARM-se), dhe perfaqesuesi i qeverisjes vendore. Ne mbledhje ftohen te marrin pjese perfaqesues te publikut te interesuar dhe te OJF-ve mjedisore lokale.
3. Per shqyrtimin e kerkeses, zbatohen kriteret dhe kerkesat e nenit 17 te ligjit Nr. 8990, date 23.01.2003, “ Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ”.
4. Vemendje te veçante mbledhja i kushton percaktimit te sakte te kushteve mjedisore ne te cilat duhet te zhvillohet veprimtaria me qellim qe ndikimet e saj negative ne mjedis te jene brenda normave te lejuara.
5. Kushtet dhe kerkesat hartohen konkrete, te matshme e te kontrollueshme. Ato pasqyrohen thjeshte dhe sakte ne autorizimin dhe ne pelqimin mjedisor qe miratohet.
6. Proces-verbali i mbledhjes firmoset nga te gjithë inspektoret, ndersa autorizimi dhe pelqimi nga pergjegjesi i agjencise rajonale te mjedisit.
7. Per çdo mbledhje miratohet nje vendim ku pasqyrohen te gjitha kerkesat e shqyrtuara, sipas formatit te miratuar nga Ministria. Çdo vendim publikohet brenda 5 ditesh nga miratimi i tij, duke u afishuar ne vend te dukshem te selia e ARM-se.

8. Autorizimi ose pelqimi mjedisor, per çdo kerkese te miratuar, hartohet ne tre kopje. Nje kopje i dorezohet propozuesit, nje i dergohet Inspektoratit te Mjedisit prane Ministrise, ndersa kopja tjeter ruhet ne ARM.
9. Kur ARM -ja vendos te mos e miratoje kerkesen, brenda 5 diteve nga data e mbledhjes, subjektit i argumentohen me shkrim arsyet e mosmiratimit.

V. Afatet

1. Gjithe procesi i pajisjes se nje veprimtarie me autorizim apo me pelqim mjedisor, eshte i lidhur ngushte me afatet dhe ARM-ja eshte pergjegjese per respektimin e tyre, sic jane percaktuar ne pika te vecanta te ketij udhezimi.
2. Afati fillon me dorezimin dhe regjistrimin e kerkeses se subjektit ne protokollin e ARM-se dhe perfundon ne daten e shpalljen e vendimit te marre nga ARM-ja.
3. Miratimi i veprimtarive te perfshira ne Aneksin 1 dhe 2, behet brenda 1 muaji nga data e regjistrimit te kerkeses ne ARM.
4. Tejkalmi i afateve vleresohet **shkelje e rëndë** per pergjegjesin e ARM-së dhe ndëshkohet sipas ligjeve ne fuqi.

VI. Tarifa

1. Per shqyrtimin e kerkeses nga ARM, subjekti parapaguan nje tarife sherbimi e cila:
 - a. Per pajisjen me autorizim mjedisor, tarifa percaktohet ne Udhezimin nr.1, date 30.11. 2005, “ Per tarifat e sherbimit te lejeve te mjedisit ”.
 - b. Per pajisjen me pelqim mjedisor, tarifa percaktohet ne Urdhrin e Ministrit nr. 4, date 07.02.2001, “ Per tarife vule ”.
2. Tarifa është parapaguar ne momentin e dorezimit te dokumentacionit e te regjistrimit te tij ne protokoll dhe eshte e pakthyeshme.
3. Tarifa derdhet nga subjekti ne banke per llogari te MMPAU me pershkrimin “ Tarife per autorizim ose per pelqim mjedisor ”.

VII. Ankimi

1. Ndaj çdo komunikimi shkresor gjate procesit te shqyrtimit te kerkeses te bere nga pergjegjesi i ARM-se, si dhe ndaj vendimit perfundimtar te miratimit ose jo te nje kerkese, subjekti ka te drejten e ankimit tek Ministri brenda 10 diteve nga marrja njoftim.
2. Brenda 10 diteve nga depozitimi i ankimit, Ministri shprehet per ceshtjen e ankimuar.
3. Ndaj vendimit te ARM, apo ndaj çdo shkelje te konstatuar, ne rast te mospergjigjes nga Ministri, mund te behet ankim ne gjykate sipas procedures se kerkuar nga neni 328 i Kodit te Procedures Civile.
4. Ndaj vendimit te ARM-se mund te ankohet edhe çdo person fizik ose juridik, publik apo privat, komuniteti dhe OJF-te mjedisore, duke respektuar procedurat dhe afatet e parashikuara nga ligji Nr. 8990, date 23.01.2003 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”.

VIII. Administrimi i dokumentave

1. Pas marrjes se vendimit, dosja e plotesuar me komunikimet zyrtare te ARM - se me propozuesin, me dokumenta shtese apo te ripunuara, me ankesat e tij eventuale me shkrim, me pergjigjet per to dhe me miratimin ose mosmiratimin, sistemohet perfundimisht, hartohet permbajtja e saj qe i ngjitet ne kapak, i vendoset numri rendor faqeve dhe ruhet ne ARM se bashku me nje kopje te vendimit te marre.
2. Dosjet e subjekteve dhe procesverbalet e mbledhjeve, ruhen per nje afat 30 vjecar.
3. Dosjet mund te shfletohen nga te interesuarit, me leje te pergjegjesit te ARM-se, duke respektuar kerkesat e rregullores “ Per ruajtjen dhe administrimin e dokumentave mjedisore ”.
4. Dosja e regjistruar në protokoll, nuk i kthehet propozuesit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Lufter XHUVELI

Aneksi 1

LISTA E

VEPRIMTARIVE VENDORE QË PAJISEN ME AUTORIZIM MJEDISOR

1. Pikë shërbimi për automjete (autoserviset);
 2. Distributor për mbushje gazi GLN, kapaciteti deri 50 m³ ;
 3. Pikë për larje e pastrim mjetesh;
 4. Pikë shitje karburanti me pakicë;
 5. Sharrim i lëndës drusore, trupa (sharra dhe gadra) ;
 6. Projektet e permiresimit te pyjeve, pyllzime, sistemime etj;
 7. Punishte perpunim druri, mobileri, tapiceri deri 1000 m³/vit;
 8. Punishte ambalazhimi uji natyral mineral; me kapacitet deri ne 500 litra ne dite
 9. Punishte prodhimi lëngje frutash, pije freskuese; pijesh alkolike me kapacitet deri ne 500 l/dite
 10. Furra të prodhimit të bukës:
 11. Kanalizime të ujrave të zeza dhe rehabilitimet e tyre;
 12. Rehabilitimi i ujësjesve egzistuese;
 13. Rikonstruksion rrugesh urbane dhe egzistuese dhe ndertimi i akseve te reja urbane;
 14. Rikonstruksioni i rrugëve rurale egzistuese dhe hapja (zgjerimi) e akseve te reja rrugore (me gjatesi deri ne 2 km);
 15. Prodhim konfeksione, trikotazhe;
 16. Punishte për perpunim qumeshti deri 10 kv/ditë;
 17. Punishte për perpunim vajrash bimore, luledielli; ulliri etj;
 18. Thertore deri 10 kv/dite;
 19. Punishte perpunimi fruta perime deri ne 10 kv/dite;
 20. Prodhim gëlqere (shuarja) deri 100 ton/vit:
 21. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikateve, pllakave etj me kapacitet deri ne 50 m³ beton/dite
 22. Magazinimi i lubrifikanteve te ambalazuara qe ne vendprodhim.
 23. Grumbullimi i skrapit dhe per qellime riciklimi me kapacitet deri ne 2 ton/dite;
 24. Grumbullimi i mbetjeve urbane per qellime riciklimi perfshi seleksionimin, coptimin mekanik dhe ambalazhimin e tyre me kapacitet deri ne 1 ton ne dite (pervec mbetjeve te rrezikshme sipas katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve);
 25. Prodhimi i kepuceve dhe aksesoreve te tjere te ngjashme pa procese kimike (qepje, ngjitje montim);
 26. Prodhimi i kartopcetave dhe ambalazheve te tjera kur per to nuk perdoren procese kimike me shkarrkime te lengshme ne mjedis me kapacitet deri ne 5 Kv/dite.
 27. Rritje artificiale e peshkut ne vaska me sipërfaqe totale te vaskave deri ne 500 m²;
-

28. Punishtetet e vogla te perpunimit i mermerit me siperfaqe totale objekti deri ne 200 m²;
 29. Ndertimi i objekteve te banimit dhe te sherbimit me siperfaqe ndertimi me te madhe se 1000 m².
 30. Verimtarite ne fushen e bujqesise si plantacionet e drureve - frutore me siperfaqe mbi 2 ha deri ne 5 ha;
 31. Veprimtarite e perpunimit (groposje, kompostim etj.) te jashqitjeve te kafsheve dhe mbeturina bimore me sasi totale pepunimi deri ne 5 kv/dite;
 32. Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri ne 10 ton;
 33. Vendet e tregtimit te kafsheve ne qiell te hapur (pazaret tradicionale) ose te mbyllur deri ne 1 ha;
 34. Tregjet urbane industriale dhe produkteve bimore dhe shtazore me siperfaqe deri ne 500 m²;
 35. Pikat e magazinimit dhe tregtimit te materialeve te ndertimit me siperfaqe totale sherbimi deri ne 1 dynym;
 36. Magazinat frigoriferike dhe te produkteve ushqimore te ambalazuara me kapacitet total magazinues deri ne 20 ton.
-

Aneksi 2

LISTA

E

VEPRIMTARIVE VENDORE QE PAJISEN ME PELQIM MJEDISOR

Do te pajisen me Pelqim mjedisor vetem ndertimi i objekteve te listuara si me poshte, ndersa ushtrimi i veprimtarive ne to do te behet pa patur nevojte per leje mjedisore.

1. Objekte te veçanta banimi;
2. Objekte te veçanta social-kulturore:
 - a. hotele;
 - b. shkolla;
 - c. kopeshte;
 - d. teatro;
 - e. kinema;
4. Lokale shërbimi (bare, restorante, diskoteka etj.);
5. Ambulanca;
6. Farmaci;
7. Laboratore;
8. Pika te vogla sherbimesh dhe tregtimi;
9. Punishte e vogël prodhimi ëmbëlsirash;
10. Rehabilitimi i lulishteve dhe parqeve;
11. Studio fotografike;

Aneksi 3



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT E QARKUT _____

Nr. Prot. _____, më.....200.....

Nr. Vendimi

A U T O R I Z I M M J E D I S O R

Në mbështetje të ligjit nr.8934, date 05.09.2002, " Per Mbrojtjen e Mjedisit ", miratohet Autorizimi Mjedisor:

Veprimtarisë:


Subjektit:

Vendndodhja:.....

Veprimtaria do të zhvillohet me keto kushte dhe kërkesa:

1. dDetajimi i kushteve për respektimin e normave të shkarkimeve në çdo nyje shkarkuese të veprimtarisë dhe në total, duke i cituar normat e përkoshshme apo të përhershme të shkarkimeve.
2. Kërkesat për zbatimin e programit të monitorimit duke përfshirë treguesit e gjendjes, të ndikimit, stacionet e marrjes së mostrave dhe frekuencën e matjes së tyre, metodën e matjes apo të llogaritjes, formatet e paraqitjes dhe të regjistrimit të të dhënave.
3. Përcaktimi i masave për uljen e konsumit të lëndëve të para, të ujit e energjisë dhe për përmirësimin e teknologjisë sipas një programi.
4. Detyrimi për të dorëzuar një herë në tre muaj të dhënat e monitorimit në agjencitë rajonale të mjedisit të qarkut dhe për t'i publikuar ato një herë në vit.
5. Përcaktimi i masave dhe afatet për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar apo ndotur.
6. Masat për trajtimin e mbetjeve dhe mbetjeve të rrezikshme.
7. Masat restauruese në rast mbyllje të veprimtarisë.
8. Afatet për përtëritjen e autorizimit mjedisor si dhe të skadimit kur veprimtaria nuk fillon të ushtrohet.
9. Detyrimi për kryerjen e vlerësimit mjedisor.
10. Detyrimi për zbatimin e kërkesave të autorizimit edhe kur veprimtaria kalon në pronësi ose përdorim të një personi tjetër.
11. Sanksionet në rast mos respektimi të kushteve të autorizimit mjedisor.
12. Tarifa e autorizimit mjedisor.

Pergjegjesi i Agjencise Rajonale te Mjedisit



Aneksi 4



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe administrimit te Ujerave
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT E QARKUT _____

Nr. prot. _____, me.....200....

Nr. Vendimi.....

PELQIM MJEDISOR

Ne mbeshetje te ligjit nr. 8934, date 05.09.2002, "Per Mbrojtjen e Mjedisit", miratohet Pelqimi Mjedisor

Projektit:
Subjektit:
Vendndodhja:.....

Projekti do te zbatoje keto kushte dhe kerkesa

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

Kushtet dhe kerkesat te perfshihen ne Lejen e Ndertimit qe do te miratoje KRRT-ja

Pergjegjesi i Agjencise Rajonale te Mjedisit

Firma, vula

KERKESE

PER T'U PAJISUR ME AUTORIZIM MJEDISOR

AGJENCISE RAJONALE TE MJEDISIT TE QARKUT

Une kerkuesi (emri, mbiemri, adresa e plote, nr. Tel, fax) do te ushtroj veprimtarine
(Nje pershkrim i shkurter i saj dhe i vendit ku do te ushtrohet)

Per kete, kam pergatitur dosjen qe permban:

1. **Fotokopje te noteruar** te vendimit te gjykates qe me ka regjistruar si person fizik ose juridik
2. **Dokumentat teknike** qe pershkruajne veprimtarine qe do te ushtroj dhe vendin ku do ta instaloj (Projekti, skica, planimetri, foto, etj.), te pergatitura nga eksperte te licensuar.
3. **Raportin** e vleresimit te ndikimit ne mjedis te veprimtarise, te hartuar nga specialiste te certifikuar e te licensuar.
4. **Dokumenta** qe vertetojne se kam diskutuar me komunitetin e OJF-te lokale dhe se keto jane dakort me zhvillimin e veprimtarise.
5. **Programin** e monitorimit te veprimtarise qe do te ushtroj.
6. **Faturen e Sherbimit (ne rast autorizimi mjedisor)**

Te cilat ja bashkelidh kesaj kerkese dhe i paraqes per shqyrtim e miratim nga ana juaj te autorizimit mjedisor.

....., me

KERKUESI

(Emri, mbiemri)

Firma, vula

Aneks 6

Raporti (i përmbledhur) i vlerësimit të ndikimit në mjedis përmban:

- a) qëllimin e projektit;
- a) përshkrimin e tij të hollësishëm;
- c) të dhënat për mjedisin ekzistues të zonës ku zbatohet projekti dhe në afërsi të saj;
- ç) përshkrimin e hollësishëm të të gjitha instalimeve, që bëjnë pjesë në projekt ose që do të përdoren gjatë zbatimit të tij;
- d) planin e ndërtimit dhe afatet e zbatimit të tij;
- dh) përshkrimin e veprave inxhinierike, që ndërtohen ose zgjerohen dhe të veprave të domosdoshme për zbatimin e projektit;
- e) ndikimet e mundshme në mjedis dhe masat e propozuara për parandalimin dhe zbutjen e tyre;
- ë) programin e monitorimit të ndikimit në mjedis të projektit;
- f) përputhjen e projektit me planet e rregullimit të territorit dhe me planet e zhvillimit ekonomik të zonës ku do të zbatohet projekti;
- g) përmbledhjen e këshillimeve me organet e qeverisjes vendore, publikun e organizatat jofitimprurëse për mjedisin dhe të mendimeve të tyre;
- gj) masat rehabilituese në rast ndotjeje dhe dëmtimi të mjedisit si dhe koston e tyre;